


PIK Creative Shpk
L12316016A
Rruga Pjetër Bogdani, Nr. 37
PASQYRA FINANCIARE 2024

**Pasqyrat Financiare
dhe Shënimet Shpjeguese
për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024**




PIK Creative Shpk
L12316016A
Rruga Pjetër Bogdani, Nr. 37
PASQYRA FINANCIARE 2024

PËRMBAJTJA

FAQJA

PASQYRAT FINANCIARE:

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA PERFORMANCËS	4
PASQYRA E KAPITALIT	5
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE	6
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE	7-19



Pasqyra e Pozicionit Financiar për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2024

(Vlerat janë shprehur në LEK)

	Shënime	Më 31 dhjetor 2024	Më 31 dhjetor 2023
AKTIVET			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	21,332,124	2,029,585
Kërkesa për arkëtim tregtare	5	87,889,863	50,022,774
Kërkesa për arkëtim tatimore	6	-	-
Të tjera kërkesa për arkëtim	6	5,520,000	1,143,000
Inventarë	7	-	-
Parapagime dhe shpenzime të shtyra	8	6,930,727	7,185,366
Totali i aktiveve afatshkurtra		121,672,714	60,380,725
Aktive afatgjata			
Parapagime dhe shpenzime të shtyra	8	-	5,803,062
Aktive afatgjata materiale	9	4,660,483	5,067,963
Totali i aktiveve afatgjata		4,660,483	10,871,025
Totali i aktiveve		126,333,197	71,251,750
DETYRIMET			
Detyrimet afatshkurtra			
Llogari të pagueshme tregtare	10	24,454,496	25,751,772
Detyrime tatimore për tatim fitimin	11	4,640,726	430,012
Detyrime tatimore dhe pagat	11	9,684,269	3,469,340
Të tjera detyrime	12	20,922,500	-
Detyrime ndaj palëve të lidhura	12	-	3,479,700
Detyrime për dividendin	13	-	3,149,177
Totali i detyrimeve afatshkurtra		59,701,991	36,280,001
Detyrimet afatgjata			
Huamarrje afatgjate	14	-	-
Totali i detyrimeve afatgjata		-	-
KAPITALI			
Kapitali i nënshkruar	15	250,000	250,000
Rezerva statutore		2,050,000	2,050,000
Rezerva të tjera		20,000,000	20,000,000
Fitim /Humbje të mbartura	15	7,491,152	7,491,152
Fitim /Humbje Ushtrimore		36,840,054	5,180,597
Totali i kapitalit		66,631,206	34,971,749
Totali i detyrimeve dhe kapitalit		126,333,197	71,251,750

Shënimet shpjeguese në faqet 7- 19 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e Performancës për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2024

(Vlerat janë shprehur në LEK)

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023
I. Të ardhurat			
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	16	227,496,522	142,605,646
Të ardhura të tjera	16	265,000	385,000
Total të Ardhurat (I)		227,761,522	142,990,646
II. Shpenzime			
Shpenzime direkte për mallrat dhe shërbimet e realizuara	17	(130,079,633)	(90,539,818)
Shpenzime të personelit	18	(38,269,140)	(30,981,455)
Shpenzime të përgjithshme dhe administrative	19	(8,362,546)	(6,591,149)
Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale	10	(1,448,502)	(1,177,986)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	19	(3,624,299)	(5,011,531)
Total shpenzimet		(181,784,120)	(134,301,939)
Fitim Humbja nga veprimtaritë kryesore (I+II)		45,977,402	8,688,707
III. Të ardhura dhe shpenzime financiare			
Të ardhura dhe shpenzime nga interesat	20	(7,656)	(21,884)
Të ardhura dhe shpenzime nga kurset e këmbimit	20	(1,047,555)	(1,051,191)
Komisione Banke	20	(154,086)	(117,351)
Të ardhura dhe shpenzime të tjera financiare	20	(756,534)	(77,230)
Të ardhura (shpenzime) financiare neto (III)		(1,965,831)	(1,267,656)
Fitimi para tatimit (I+II+III)		44,011,571	7,421,051
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	21	(7,171,517)	(2,240,454)
Fitimi (Humbja) e Vitit		36,840,054	5,180,597
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:			
Diferencat e këmbimit në përkthimin e operacioneve të huaja		-	-
Fitim/(humbje) në rivlerësimin e pronës		-	-
Fitim/(humbje) në aktivet financiare të disponueshme për shitje		-	-
Pjesa e të ardhurave gjithëpërfshirëse të pjesëmarrjeve		-	-
Të ardhura të tjera totale gjithëpërfshirëse për vitin		-	-
Të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin		36,840,054	5,180,597
Fitim/(humbje) i atribueshem për:			
Pronarët e shoqërise mëmë		36,840,054	5,180,597
Interesa jo-kontrolluese		-	-
Fitimi/(humbja) për vitin		36,840,054	5,180,597
Të ardhura/(humbje) totale të atribueshme për:			
Pronarët e shoqërise mëmë		36,840,054	5,180,597
Interesa jo-kontrolluese		-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		36,840,054	5,180,597

Shënimet shpjeguese në faqet 7- 19 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e Kapitalit për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2024

(Vlerat janë shprehur në LEK)

	Kapitali i regjistruar	Rezerve ligjore	Rezerva statutore	Rezerva të tjera	Fitime të mbajtura	TOTAL
Më 01 Janar 2023						
Fitim/(Humbja) e vitit	250,000	-	2,050,000	20,000,000	7,491,152	29,791,152
Shtim Kapitali	-	-	-	-	5,180,597	5,180,597
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse	250,000	-	2,050,000	20,000,000	12,671,749	34,971,749
Transferim në rezervë	-	-	-	-	-	-
Dividend për tu paguar	-	-	-	-	-	-
Më 31 Dhjetor 2023	250,000	-	2,050,000	20,000,000	12,671,749	34,971,749
Më 01 Janar 2024						
Fitim/(Humbja) e vitit	250,000	-	2,050,000	20,000,000	12,671,749	34,971,749
Shtim Kapitali	-	-	-	-	36,840,054	36,840,054
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse	250,000	-	2,050,000	20,000,000	49,511,803	71,811,803
Transferim në rezervë	-	-	-	-	-	-
Dividend të paguar	-	-	-	-	(5,180,597)	(5,180,597)
Më 31 Dhjetor 2024	250,000	-	2,050,000	20,000,000	44,331,206	66,631,206

Shënimet shpjeguese në faqet 7 - 19 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2024

(Vlerat janë shprehur në LEK)

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023
Flukse monetare nga veprimtari shfrytëzuese:		
Fitimi para tatimit	44,011,571	7,421,051
<i>Rregullime për:</i>		
Amortizimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo-materiale	1,448,502	1,177,986
Humbjen nga kembimet valutore	-	-
Të ardhurat nga interesi	-	-
Shpenzimet për interesa	-	-
Shpenzimet për Tatim fitim	(7,171,517)	(2,240,454)
<i>Fitimi operativ para ndryshimeve në kapitalin punues</i>	<u>38,288,556</u>	<u>6,358,583</u>
 Zvogëlimi / (rritja) e inventarëve	-	-
Zvogëlimi / (rritja) e kërkesave për arkëtim	(33,655,596)	3,708,695
(Zvogëlimi) / rritja e llogarive të pagueshme	30,066,430	(8,014,271)
	<u>(3,589,166)</u>	<u>(4,305,576)</u>
 Interes i arkëtuar		
Tatim fitimi i paguar	(2,960,803)	(2,837,392)
Paraja neto nga aktivitetet operative	<u>31,738,587</u>	<u>(784,385)</u>
 Flukse monetare nga veprimtaritë investuese:		
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	(1,041,022)	(1,185,004)
Blerje e aktiveve afatgjata jo-materiale	-	-
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	-	-
Paraja neto nga aktivitetet investuese	<u>(1,041,022)</u>	<u>(1,185,004)</u>
 Flukse monetare nga veprimtaritë financuese:		
Arkëtime nga derdhja e kapitalit	-	-
Arkëtime nga huamarrjet dhe qiratë financiare	(3,479,700)	(6,342,650)
Pagese për huamarrjet dhe qiratë financiare	-	-
Pagesë Dividendi	(7,915,326)	(5,750,317)
Paraja neto veprimtaritë financuese	<u>(11,395,026)</u>	<u>(12,092,967)</u>
 Pakësimi neto i mjeteve monetare	<u>19,302,539</u>	<u>(14,062,356)</u>
Mjete monetare dhe ekuivalente me to në fillim të vitit	2,029,585	16,091,941
Mjete monetare dhe ekuivalente me to në fund të vitit	<u>21,332,124</u>	<u>2,029,585</u>

Shënimet shpjeguese në faqet 7 - 19 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Administratori
Ardit Koleci

Hartuesi i Pasqyrave Financiare


PKK
L12316016A
PJETER BOGDANI, NR. 37




Shënimet shpjeguese për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Vlerat janë shprehur në LEK)

1. Informacion i përgjithshëm

PIK Sh.p.k. (referuar si “Shoqëria”) është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) më datë 16 Nëntor 2011. Veprimtaria e Shoqërisë rregullohet në përputhje me dispozitat përkatëse të Ligjit 9901, datë 14 prill 2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, si dhe nga statuti i saj. Aktiviteti i shoqërisë konsiston në:

- o Ofrimi i shërbimeve grafike, dizenjim, editori, dizenjim faqe web, grafike multimediale, fushata promociionale prodhimesh, fushata sociale, packaging, reklama, ilustrime, broshura, katalogje elektronike dhe aktivitete të tjera në fushën e grafikes, dizenjim realizime mediatike dhe marrëdhënie me publikun, organizim eventesh, tregti materiale për organizim eventesh ndriçim, foni, dekorime, konsulence për organizim eventesh, ide për marketing dhe të gjitha aktivitetet e tjera financiare të lidhura me përmbushjen e objektit të shoqërisë.
- o Agjensi publicitare, marketing, blerje në media, planifikim buxheti mediatik, konsulencë në fushën mediatike, organizim dhe drejtim të aktiviteteve promociionale dhe reklamuese, organizim dhe financim/sponsorizim i eventeve të ndryshme. Në përputhje me legjislacionin shqiptar, në mënyrë që të arrihet qëllimi i sipërpërmendur, shoqëria mund:
- o Të kryej cdo aktivitet publikimi tregtar, financiar, dhënie - marrje me qira, të vendosë pengje dhe barrë hipotekore; aktivitete keto të konsideruara si të dobishme apo të nevojshme për të arritur qëllimin e shoqërisë dhe që nuk tejkalojnë në masë aktivitetet kryesore, të sipërcituara.
- o Të kryej aktivitete publikimi dhe reklamimi. Shoqëria kryen çdo lloj aktiviteti që bën pjesë në objektin e saj që lidhen me të dhe që e mbështet atë. Shërbime monitorimi të medias dhe analiza mediatike. Konsulence në menaxhim dhe administrim. Konsulence në plane biznesi profesionale, planifikim financiar, analize konkurrence. Konsulence në fushën e marketingut për zhvillim tregu dhe rritje të shitjeve. Konsulence në zhvillime të produkteve dhe shërbimeve. Konsulence për Web Zhvillim, Internet Marketing, IT Services.

Kapitali i regjistruar i shoqërisë është 250,000 lekë i përbërë nga 3 (tre) kuota sipas:

- Alban Fejzaj, që zotëron 50% kuota me vlerë nominale 125,000 lekë.
- Ardit Koleci, që zotëron 25% kuota me vlerë nominale 62,500 lekë.
- Glon Bakalli, që zotëron 25% kuota me vlerë nominale 62,500 lekë.

Selia e Shoqërisë ndodhet në **Rruga Pjetër Bogdani Nr.37, Kati 2, Tiranë**. Përfaqësues ligjor i shoqërisë është **Z. Ardit Koleci**.

Numri i punonjësve të Shoqërisë më 31 dhjetor 2024 është **28 (njëzet e tetë)** punëmarrës.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat Financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara (SKK) dhe Ligjin nr. 25/2018, datë 10 maj 2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Në bazë të urdhrit nr. 64 datë 22.7.2014 “Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre”, Ministria e Financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015. Në bazë të urdhrit nr. 134 datë 21.07.2021 “Për ndryshimin e referencës ligjore të standardeve kombëtare të kontabilitetit”, Ministria e Financave vendosi ndryshimin e referencës ligjore për Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara në përputhje me Ligjin 25/2018 duke filluar nga 1 janari 2019.

Në bazë të urdhrit nr. 16 datë 09.02.2024 “Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre SKK 2023”, Ministria e Financave vendosi të

Shënimet shpjeguese për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Vlerat janë shprehur në LEK)

shpalljen e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përditësuara në vitin 2023 (SKK 2023). Përditësimet e SKK 2023 kanë datë efektive nga 1 janari 2025 dhe aplikohen në prospektivë pa ndryshime të raportimeve të periudhave të mëparshme.

2.2. Parimi i vijimësisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në parimin e vijimësisë. Të drejtat dhe detyrimet e Shoqërisë më 31 dhjetor 2024 janë paraqitur duke u nisur nga supozimi se Shoqëria do të jetë në gjendje t'i arkëtojë dhe t'i shlyejë këto të drejta dhe detyrime gjatë rrjedhës normale të biznesit.

2.3. Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të performancës të krijuara në periudhën kontabël. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme


Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

3. Politikat kontabël kryesore

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në periudhat e paraqitura, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe.



Shënimet shpjeguese për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Vlerat janë shprehur në LEK)

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e raportimit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisht të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e performancës. Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 është detajuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
EUR/Lek	98.15	103.88
USD/Lek	94.26	93.94

3.2 Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e performancës. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivët financiarë çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare


Mjetet monetare dhe ekuivalente me to përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se Shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar dhe mospagesa apo pagesa e vonuar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.



Shënimet shpjeguese për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Vlerat janë shprehur në LEK)

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e performancës çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e performancës janë përlogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Të tjera

Instrumenta të tjerë joderivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të pasasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivët e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e performancës.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivët financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e performancës.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në pasqyrën e pozicionit financiar me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4 Aktive afatgjata materiale

Njohja dhe matja

Të gjitha aktivët afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin, nëse ka, dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Shënimet shpjeguese për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Vlerat janë shprehur në LEK)

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e performancës.

Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që Shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivët e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit. Metodatat dhe përqindjet e amortizimit të aktiveve afatgjata për periudhën 2024 dhe 2023 janë si më poshtë:

Mobilje dhe orendi	Lineare	20%
Pajisje Informatike	Lineare	25%
Mjete transporti e të tjera	Lineare	20%
Aktive afatgjata jomateriale	Lineare	5%

3.5 Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë. Shoqëria i njeh të ardhurat nga kryerja e shërbimeve në përpjesëtim me fazën e përfundimit të shërbimit në datën e raportimit. Faza e përfundimit të shërbimeve vlerësohet mbi ecurinë e punëve të kryera.

3.6 Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7 Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e performancës nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve. Shoqëria ka vetëm qira operative. Pagesat e qirasë operative njihen në pasqyrën e performancës me metodën lineare përgjatë periudhës së qirasë. Stimujt e qirasë së përfituar njihen në pasqyrë si pjesë integrale e shpenzimit total të qirasë, përgjatë periudhës së qirasë.

3.8 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e performancës. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të

Shënimet shpjeguese për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Vlerat janë shprehur në LEK)

drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e performancës me metodën e interesit efektiv.

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e performancës përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital. Tatimi aktual është tatimi i prituri për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2024 është 15% (2023: 15%). Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve pasqyrës së pozicionit financiar, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore. Shoqëria nuk ka njohur tatim të shtyrë për humbjet e mbartura fiskale.

3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet shoqërore për pensione, në emër të vet dhe për punonjësit në përputhje me legjislacionin shqiptar. Kostot e kryera për sigurimet në emër të shoqërisë paraqiten në pasqyrën e performancës. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributesh pensioni të përcaktuar.

3.11. Transaksionet me palët e lidhura


Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.13. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.



Shënimet shpjeguese për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Vlerat janë shprehur në LEK)

4. MJETET MONETARE

Mjetet monetare më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Llogari rrjedhëse:		
Lek	19,277,308	520,613
Euro	29,578	1,029,864
Usd	1,584,098	2,208
	20,890,984	1,552,685
Arka:		
Lek	441,140	476,900
TOTALI	21,332,124	2,029,585

5. KËRKESA TË ARKETUESHME TREGTARE

Kërkesat e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Klientë	87,889,863	50,022,774
TOTALI	87,889,863	50,022,774

6. TË TJERA KËRKESA PËR ARKËTIM

Të tjera kërkesa për arkëtim më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Të tjera kërkesa për arkëtim	5,520,000	1,143,000
TOTALI	5,520,000	1,143,000

7. INVENTARI

Për shkak të natyrës së aktiviteteve të kryera nga Shoqëria gjatë viteve 2024 dhe 2023, Shoqëria nuk ka gjendje inventari.

8. PARAPAGIME DHE SHPENZIME TË SHTYRA

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Parapagime	146,342	286,703
Shpenzime të shtyra	6,784,385	6,898,663
Shpenzime të shtyra afatgjata	-	5,803,062
TOTALI	6,930,727	12,988,428

9. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

Aktivët afatgjata materiale më 31 dhjetor 2024 përbëhen si më poshtë:



Shënimet shpjeguese për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Vlerat janë shprehur në LEK)

	Mjete transporti	Pajisje zyre, mobilie	Pajisje informatike	Të tjera	Totali i Aktiveve Fikse
AQT me kosto historike					
Teprica me 1 Janar, 2024	3,605,875	2,287,553	5,414,460	615,709	11,923,597
Shtesa nga blerjet	-	222,809	818,213	-	1,041,022
Transferime nga zëra të tjerë	-	-	-	-	-
Teprica me 31 Dhjetor, 2024	3,605,875	2,510,362	6,232,673	615,709	12,964,619
Amortizimi i akumuluar					
Teprica me 1 Janar, 2024	(1,701,973)	(1,571,819)	(3,370,060)	(211,781)	(6,855,634)
Shtesa e vitit	(380,780)	(231,842)	(755,094)	(80,785)	(1,448,502)
Transferime nga zëra të tjerë	-	-	-	-	-
Teprica me 31 Dhjetor, 2024	(2,082,753)	(1,803,661)	(4,125,154)	(292,566)	(8,304,136)
Balanca me 31 Dhjetor, 2024	1,523,122	706,701	2,107,519	323,143	4,660,483

10. LLOGARI TË PAGUESHME TREGTARE

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Furnitorë	21,503,528	25,726,772
Furnitorë për fatura të pambërritura	2,950,968	25,000
TOTALI	24,454,496	25,751,772

11. DETYRIME TATIMORE

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Tatim mbi të ardhurat personale	441,048	468,671
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	857,248	1,172,744
Tatim mbi vlerën e shtuar	8,116,419	1,797,467
Tatim në burim	38,986	30,458
Detyrime për pagat	230,568	-
Tatim mbi fitimin	4,640,726	430,012
TOTALI	14,324,995	3,899,352

12. TË TJERA DETYRIME

Detyrimet e tjera më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Parapagime të marra	20,922,500	-
TOTALI	20,922,500	-

Shënimet shpjeguese për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Vlerat janë shprehur në LEK)

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Detyrime ndaj palëve të lidhura	-	3,479,700
TOTALI	-	3,479,700

13. DETYRIME PËR DIVIDENDIN

Shoqëria më 31 dhjetor 2024 nuk ka detyrime për dividendin (2023: 3,149,177 lekë).

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Detyrime për dividendin	-	3,149,177
TOTALI	-	3,149,177

14. HUAMARRJE AFATGJATË

Shoqëria më 31 dhjetor 2024 nuk ka detyrime për huamarrje afatgjatë.

15. KAPITALI I NËNSHKRUAR

Kapitali i pronarit më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Kapitali	250,000	250,000
Rezerva statutore	2,050,000	2,050,000
Rezerva të tjera	20,000,000	20,000,000
Fitimi/Humbja e pashpërndarë	7,491,153	7,491,152
TOTALI	29,791,153	29,791,152

16. TË ARDHURA

Shoqëria ka realizuar të ardhura gjatë vitit 2024 të lidhura me aktivitetin e saj. Shoqëria ka njohur të ardhurat atëherë kur ka konsideruar të mundshme që do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe keto përfitime mund të maten me besueshmeri. Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

Sipas kesaj metode, efektet e transaksioneve dhe ngjarjeve të tjera janë njohur në pasqyrat financiare kur ato kanë ndodhur (dhe jo kur paraja ose ekuivalentet e saj janë arkëtuar ose paguar) dhe janë njohur në kontabilitet e raportuar në pasqyrat financiare të periudhave kontabël, të cilave u përkasin.

Të ardhurat e shoqërisë gjatë vitit 2024 dhe 2023 paraqiten si më poshtë vijon:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2024	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2023
Të ardhura nga shërbimi	227,496,522	142,605,646
Të ardhura të tjera	265,000	385,000
TOTALI	227,761,522	142,990,646

Të ardhurat ndahen sipas shërbimeve kryesore të realizuara nga shoqëria gjatë vitit 2024:

Shënimet shpjeguese për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024*(Vlerat janë shprehur në LEK)*

Shitje shërbime Kreative	24,596,902	26,196,015
Shitje shërbime Digital	17,429,418	4,484,030
Prodhime (production, printime etj.)	1,595,297	8,516,619
Organizim Eventi	131,261,031	57,809,841
Prodhim Shitje Shërbime Audio Visual	4,802,182	21,589,763
Shitje Media Buying	47,811,693	24,009,377
Qira	265,000	385,000
TOTAL	227,761,522	142,990,646

Rakordim i shifrës së afarizmit me FDP 2024:

I. Deklarimi sipas Librave (FDP)	
Shitje të tatueshme	238,153,596
Shitje pa TVSH	10,265,438
Shitje të përjashtuara	265,000
TOTAL	248,684,034

II. Deklarimi sipas PF 2024	
Të ardhura nga shërbimi	227,496,522
Të ardhura të tjera	265,000
TOTAL	227,761,522

DIFERENCA I-II	20,922,512
-----------------------	-------------------

RAKORDIM DIFERENCA	
- Parapagime gjatë 2024 që i takojnë vitit 2025	(20,922,500)
- Rrumbullakime	(12)
TOTAL	-

17. KOSTO DIREKTE SHËRBIMI

Mallrat dhe shërbimet që lidhen direkt me të ardhurat e përfituara gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 detajohen si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2024	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2023
Shërbime design dhe kreative	10,766,110	15,210,699
Shërbime dixhitale	1,620,696	2,681,407
Shërbime printi dhe prodhime	911,969	5,222,883
Shërbime organizim eventi	76,664,357	44,251,260
Shërbime realizime video	6,897,738	11,016,440
Shërbime media	33,218,763	12,157,129
TOTALI	130,079,633	90,539,818

18. SHPENZIME PERSONELI

Shënimet shpjeguese për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Vlerat janë shprehur në LEK)

Shpenzimet e personelit gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 përbëhet si me poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2024	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2023
Pagat e personelit	33,004,011	26,671,220
Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	5,265,129	4,310,235
TOTALI	38,269,140	30,981,455

19. SHPENZIME TË PËRGJITHSHME DHE ADMINISTRATIVE

Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 përbëhen si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2024	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2023
Blerje, energji, avull, ujë	305,911	338,747
Shpenzime qira	2,744,937	2,215,472
Shërbime noteriale dhe përkthimi	107,082	129,154
Shërbime interneti	132,719	201,363
Shërbim sigurie	60,000	60,000
Shpenzime certifikimi, anëtarësimi	1,256,769	75,000
Shërbim IT	820,061	507,073
Shpenzime kancelarike	275,244	321,610
Shërbime financiare	630,000	936,140
Shërbime ligjore	190,000	-
Transferime, udhëtime, dieta	1,416,421	1,411,066
Shpenzime postare dhe telekomunikimi	423,402	395,524
TOTALI	8,362,546	6,591,149

Shpenzimet e tjera gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 përbëhen si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2024	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2023
Shpenzime për pritje dhe përfaqësime	988,174	1,175,061
Shpenzime transporti	240,280	457,001
Blerje/Shpenzime të tjera (kafe, detergjente etj)	595,232	717,517
Taksa dhe tarifa vendore	74,500	168,800
Gjoha dhe penaltete	115,483	481,424
Shpenzime të tjera	1,610,630	2,011,728
TOTALI	3,624,299	5,011,531

20. TË ARDHURA (SHPENZIME) FINANCIARE, NETO

Të ardhurat (shpenzimet) financiare gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 përbëhen si më poshtë:



Shënimet shpjeguese për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Vlerat janë shprehur në LEK)

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2024	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2023
Të ardhura nga interesa	823	386
Shpenzime për interesa	(8,479)	(22,270)
	(7,656)	(21,884)
Fitime të realizuara nga kursi kembimit	634,369	827,502
Humbje të realizuara nga kursi kembimit	(1,681,924)	(1,878,693)
	(1,047,555)	(1,051,191)
Komisione bankare	(154,086)	(117,351)
Të ardhura dhe shpenzime të tjera financiare	(756,534)	(77,230)
TOTALI	(1,965,831)	(1,267,656)

21. TATIM- FITIMI

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin aktual dhe tatimin e shtyrë. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin njihet si fitim ose humbje përveç nëse lidhet me zëra të njohur direkt në kapital, rast në të cilin njihet në kapital. Tatimi aktual është tatimi që pritët të paguhet mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke përdorur normen tatimore në fuqi ose që konsiderohet në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo sistemim të tatimit të pagueshëm për vitet e mëparshme. Tatimi i shtyrë lind nga ndryshimet mes vlerave të njohura për aktivet dhe detyrimet e shoqërisë të paraqitura në pasqyrën e pozicionit financiar në përputhje me kërkesat e SKK dhe vlerave të njohura të këtyre aktiveve dhe detyrimeve nga autoritetet tatimore.

Bazuar në legjislacionin shqiptar, norma e tatimit mbi fitimin është 15 % për vitin 2024 (2023:15%).

Rakordimi i fitimit kontabël me fitimin fiskal

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2024	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2023
Fitimi (humbja) kontabël e vitit	44,011,571	8,599,037
Rregullime për zëra shpenzimesh të panjohura:	3,798,543	7,515,309
Fitimi (humbja) fiskale e vitit	47,810,114	16,114,346
Shpenzime të Tatim Fitimit	(7,171,517)	(2,417,152)
Fitimi (humbja) fiskale e vitit neto	40,638,597	13,697,194
Parapagim tatim fitim	2,530,791	1,810,442
Balanca TF për vitin pasardhës/(për pagesë)	(4,640,726)	(606,710)

Deklaratat tatimore dorëzohen çdo vit por të ardhurat dhe shpenzimet e deklaruar për qëllime tatimi konsiderohen vetëdeklarime deri në momentin që autoritet tatimore shqyrtojnë deklaratat dhe regjistrimet e tatimpaguesit dhe bëjnë vlerësimin final. Ligjet dhe rregullat tatimore shqiptare janë objekt interpretimi nga autoritet tatimore.

Shënimet shpjeguese për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Vlerat janë shprehur në LEK)

Për vitet e mbyllura më 31 dhjetor 2024 dhe 2023, Shoqëria ka rezultuar me fitim kontabël dhe fiskal.

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2024	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2023
Tatim-fitimi	7,171,517	2,417,152
TOTALI	7,171,517	2,417,152

Këto pasqyra financiare u aprovuan dhe u nënshkruan nga Drejtimi i Shoqërisë më 27 mars 2025.

Administrator

Ardit Koleci


PIB
L12316016A
PJETER BOGDANI, NR. 37